



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr.Dok. 202001861/11

Tiranë 29 / 12 /2020

**Lënda:** Rekomandim për të garantuar respektimin e të drejtës për përfitimin nga rindërtimi i banesës të dëmtur prej fatkeqësisë natyrore, të qytetarit z.B.B

**Drejtuar :** BASHKISË  
Z.Kryetar

**KORÇË**

I nderuar Z.Kryetar,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, siç jeni në dijeni, ka paraqitur një ankesë/kërkesë shtetasi z.B.B, i cili ankohet/kërkon ndërtimin e banesës pas shpalljes së pabanueshme të saj shkaktuar nga tërmeti i datës 01.06.2019.

Konkretisht ankuesi shprehet ndër të tjera se ".....pas tërmetit të datës 01.06.2019 Bashkia Korçë vendosi të rindërtojë banesat e pabanueshme për të cilat ka dërguar ekspertë për verifikim. Ekspertët kanë qenë disa herë në banesën e ankuesit dhe e kanë shpallur të pabanueshme. Në fillim z.B shprehet se emri i tij figuronte në listën e banesave të dëmtuara por më pas jo pasi kishte banesë të dytë në Tiranë. Ai në Tiranë ka marrë një dokument që verifikon se nuk ishte aplikues i ndonjë banese informale në Tiranë. Më pas Ju i jeni shprehur se duhet të aplikojë përsëri por ende pa përgjigje shprehet ankuesi. Ankuesi thekson se ai ka kryer ndryshimin e vendqëndrimit nga fshati Flloq për në Tiranë me një kërkesë nr.prot 1479, datë 27.12.2018 me deklaratë noteriale me arsyetimin se do të ndryshojë vendqëndrim duke jetuar përkohësisht në katin përdhes të djalit të tij pasi i duhet të qëndrojë në Tiranë për arsye shëndetësore të bashkëshortes së tij. Ajo ka kryer një ndërhyrje në zemër dhe i duhet të marrë shërbim herë pas here në spitalin Nënë Tereza. Ankuesi pjesën më të madhe të vitit sidomos në stinën e pranverës dhe verës ka qëndruar në atë banesë edhe në momentin e rënies së tërmetit në muajin Qershor 2019".

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike shqiptare, në përputhje me nenin 2 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", ka konstatuar se rasti plotëson kushtet për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, pasi ankuesi është shtetas shqiptar, subjekti ndaj të cilit ai ankohet është organ i administratës publike, dhe objekti i ankesës është një pretendim për veprim të paligjshëm/parregull të kësaj të fundit.

Për sa më lart, bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/a , ka vendosur t’ a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë një proces hetimi administrativ.

### **ANALIZA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT, KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj ankese dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, kemi kërkuar fillimisht nga Bashkia Korçë me shkresën nr.prot K3/B12-3, datë 15.06.2020 të na përcillen informacione nëse qëndron pretendimi i ankuesit, çdo lloj informacioni që ka të bëjë me këtë çështje si dhe veprimet që ishin ndërmarrë apo do të ndërmerreshin për zgjidhjen e kësaj çështje jetike.

Me shkresën nr.prot 4221/1, datë 24.06.2020, shpreheni ndër të tjera se banesa e tij është verifikuar nga komisioni i ngritur për verifikimet e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 01.06.2019 dhe në momentin e verifikimit nuk banohej në këtë banesë. Ky fakt është i qartë sipas fotove të mbledhura si dhe përforcohet nga fakti se nuk ka kontratë të energjisë elektrike në emër të tij. Edhe nëse e ka në emër të babait të tij konsumi është zero për periudhën maj 2018-prill 2019. Gjithashtu nga verifikimi në gjendjen civile ky ankues është banor i ish komunës Paskuqan. Ju shpreheni se ligji për emergjencat civile, merret me trajtimin e rasteve emergjente dhe jo me banesat që nuk përdoren.

Sa më sipër, ju kemi kërkuar me shkresën nr.prot K3/B12-5, datë 08.07.2020 duke shprehur të gjithë mirëkuptimin tonë ndaj vlerësimit të komisionit të ngritur nga ana Juaj, të gjithë arsyetimin ligjor **të detajuar** lidhur me mos trajtimin nga ana juaj të këtij rasti ku shpreheni se kjo banesë është e pabanueshme, ligji për emergjencat civile merret me trajtimin e rasteve emergjente dhe jo me banesat që nuk përdoren si dhe informacion se ku e bazoni ju këtë qëndrim, sa raste të ngjashme janë konstatuar me të njëjtën problematikë. Kjo pasi e drejta e pronës është një e drejtë kushtetuese dhe një nga të drejtat themelore të njeriut është gëzimi lirisht i saj e cila dhe mbrohet nga kushtetuta dhe nga aktet respektive ndërkombëtare e rajonale. Po kështu Kodi civil përshkruan të gjitha tagret që ka pronari mbi sendin për ta poseduar, **gëzuar**, e disponuar. Kushtetuta parashikon se dëmet që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore përballohen nga shteti. Ligji për emergjencat civile shpreh detyrimin që ka shteti për të gjitha dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Me shkresën nr.prot K3/B12-7, datë 22.10.2020, ju kemi vënë në dijeni se ankuesi ka marrë vërtetim të paraqitur pranë jush që nuk është në proces legalizimi të ndonjë objekti në emrin e tij.

Ju shpreheni në shkresën nr.prot 4221/3, datë 26.10.2020, se nga grupi i verifikimit në vend është matur objekti dhe është hartuar planimetria ku më pas është hartuar edhe preventivi i dëmeve të shkaktuara. Në vijim të procedurës është kërkuar nga të gjithë kryefamiljarët certifikata familjare. Nga ky informacion i marrë nga Bashkia Korçë rezulton se z.B nuk ishte banor i fshatit Flloq por i Njësisë Administrative Paskuqan, Tiranë. Nga verifikimi i abonentëve të OSHEE ankuesi nuk ka kontratë në emër të tij. Kontrata është në emër të babait të tij ku rezulton se konsumi për periudhën Maj 2018-Prill 2019 është 0. Nga sa më sipër bashkia shprehet se arritëm në konkluzionin se banesa është e abandonuar. Bashkia Korçë ka paraqitur dokumentacionin në Këshillin e bashkisë për miratimin e listave përfundimtare **të objekteve të dëmtuara** nga tërmeti dhe të cilat do të kompesohen në vlerë financiare. Në mbledhje u diskutua rreth shtëpive të dyta dhe atyre të abandonuara nga ku u konkludua të mos trajtohen pasi **përparësi** do të kenë banesat të cilat kanë qenë të banueshme dhe banorët ngelen pa strehë. Nëse i referohemi VKM 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare

për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore....”, pikërisht në Kreun III, pika 2, gërma ç, parashikon se në dokumentacionin e nevojshëm shqyrtimin e përfitimit të ndihmës financiare është çertifikata familjare. Ky ankues nuk ka qenë banues i fshatit Fllor para dhe as pas rënies së tërmetit.

Me shkresën nr.prot K3/B12-10, datë 27.11.2020, Z. ka paraqitur pranë Avokatit të Popullit përgjigjen e ardhur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit pas ankesës së tij. Në të thuhet ndër të tjera duke e këshilluar ankuesin ti drejtohet organeve gjyqësore për depozitimin e një padie. Në kushtet e kalimit të afatit të parashikuar ligjor, nëpërmjet avokatit tuaj, duhet të bëni kërkesë për rivendosje në afat sipas parashikimeve në nenin 54 të KPA.

Pasi kemi analizuar me kujdes edhe një herë shpjegimet e përcjella nga ana juaj, konstatojmë se në shkresat tuaja, Ju na shpjegoni edhe një herë rrethanat e rastit por nuk shpreheni lidhur me problematikën në themel, të drejtën për përfitim për rregullimin e pronës (banesës) si edhe nuk keni bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të kërkuar nga ana jonë, dhe as ndonjë dokumentacion tjetër që të mbështesë shpjegimet e sqarimet tuaja, dhe të vërtetojë qasjen apo sjelljen që ka pasur dhe ka bashkia ndaj qytetarëve në këto raste të vështira humane, e për më tepër arsyen tjetër humane të ndryshimit të vendbanimit të përkohshëm të tij për shkaqe shëndetësore.

Në këtë kontekst, referuar misionit të bashkisë si organ i pushtetit vendor që siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve<sup>1</sup> vlerësojmë se ka vend për përmirësim në qasjen që bashkia si organ kyç i pushtetit vendor duhet të ketë ndaj qytetarëve, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre.

Në shpjegimet tuaja nuk citohet/dokumentohet dispozita specifike se ku parashikohet konkretisht mos përfitimi i të drejtës për ndërtim, qoftë edhe nëse është banesë e braktisur në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore (për më tepër që ka një arsye të fortë shëndetësore për ndryshimin e përkohshëm të vendqëndrimit). Sa ju kemi cituar në shkresat e mësipërme ku e drejta e pronës është një e drejtë kushtetuese dhe një nga të drejtat themelore të njeriut është gëzimi lirish i saj e cila mbrohet nga kushtetuta dhe nga aktet ndërkombëtare. Po kështu Kodi civil përshkruan të gjitha të drejtat që ka pronari mbi sendin për ta poseduar, **gëzuar** dhe disponuar. Kushtetuta thotë se dëmet që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore përballohen nga shteti. Ligji për emergjencat civile shpreh detyrimin që ka shteti për të gjitha dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe nuk shpreh në asnjë rast përjashtimin nga përfitimet për banesat e “braktisura”. Ankuesi nuk ka ndonjë banesë në emrin e tij qytetin e Tiranës, por ka ndryshuar vendqëndrim për arsyet e sipërcituara. Ai nuk ka marrë shërbime në bashkinë Korçë si qytetar i RSH, qoftë edhe duke u dëgjuar apo orientuar lidhur me problematikën e tij.

Bashkia shprehet se nga ana e punonjësit të shërbimit i është komunikuar ankuesit se nuk mundet të jetë përfitues për rindërtimin e banesës por nuk është dëgjuar e as orientuar qytetari. Cilado që të ketë qenë forma e adresimit ndaj qytetarit, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se ndodhemi para rastit të refuzimit të ofrimit të shërbimit publik ndaj qytetarit, në kundërshtim të hapur me parimet e ofrimit dhe sigurimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve, si parimi i ligjshmërisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, transparencës e proporcionalitetit, referuar ligjit nr. 13/2016 por edhe Kodit të Procedurave Administrative. Bashkitë si ofruese të shërbimeve duhet të jenë më fleksibël për të dëgjuar e adresuar drejt qytetarët.

<sup>1</sup> Sipas nenit 3 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Nga ana tjetër, vlerësojmë të sjellim në vëmendje faktin se organet e pushtetit vendor, si organet qeverisëse të cilat janë më afër qytetarit se çdo organ tjetër, duhet të kujdesen që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet në mënyrë arbitrare dhe jo proporcionale asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta. Organi i pushtetit vendor duhet të reflektojë një sjellje e cila të mos jetë përjashtuese apo diskriminuese kundrejt grupeve të caktuara qytetarëve të cilët kanë të drejta të barabarta pavarësisht gjendjes apo përkatësisë ekonomike, sociale, kulturore, etnike, arsimore, etj.

Në vendimin nr.329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në gërmën b, pika 2, thuhet se b) Këshilli i Qarkut, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, përgatit listat përmbledhëse për **subjektet private të pronave të dëmtuara**, preventivat që miratohen nga ministritë e linjës për sektorët që ato mbulojnë, si dhe plotëson dokumentacionin me certifikatën familjare, fotokopjen e dokumentit të identifikimit dhe i paraqet ato në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Brendshme. Pra, nuk shprehet se përgatit listat për banorët, por për **pronat e dëmtuara, subjekte private të pronave të dëmtuara**.

Po kështu në të gjithë vendimin e mësipërm përmenden nocione si banesa private apo subjekte private të pronave. Në gjykimin tonë, sa argumentuam më sipër, nuk shprehet se detyrimisht duhet të ishte banor në atë moment në mënyrë që të përfitonte nga ndërtimi i banesës.

Njësia e pushtetit vendor ka detyrimin e saj ligjor që të vlerësojë dëmet e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore për secilin **objekt të subjekteve** të evidentuara paraprakisht nga ana e komisioneve të vlerësimit, si edhe të parashikuara në gërmën a, pikën 1 të VKM 329, datë 16.05.2012.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua në këtë rekomandim, vlerësojmë se sjellja e Bashkisë Korçë përkundrejt ankuesit por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve.

Sa më lart, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

#### **REKOMANDOJMË:**

- Bashkia Korçë të marrë masa për të garantuar respektimin e të drejtës së qytetarit për përfitimin e ndërtimit të banesës si shkak i fatkeqësisë natyrore, konkretisht shtetasit z.B.B.
- Bashkia Korçë gjatë ushtrimit të veprimtarisë në drejtim të ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët të jetë më fleksibël duke dëgjuar/adresuar drejt qytetarët, si dhe duke respektuar maksimalisht të drejtat e tyre;

Lutemi që të njoftohemi brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi për masat apo veprimet e ndërmarra nga Bashkia Korçë.

*Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Prof.As.Dr.Erjona BANA(CANAJ)**